



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës suaj administruar me nr. 24171 datë 17.12.2021, me anë të së cilës kërkonti informacion në lidhje me zbatimin e programit të strehimit social të “Banesave sociale me qira”, sqarojmë që:

Bashkia Shkodër po zbaton tre programe të Banesave sociale me qira, dy nga të cilat janë objekte të dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes së veprimtarisë dhe të cilat kanë kaluar në fond të banesave sociale me qira, si më poshtë:

- Banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për familjen nr. 6” e dedikuar për jetimët që dalin nga institucionet dhe familjet një prindërore, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me ministrinë e linjës, ku janë në dispozicion 24 apartamente sociale me qira: garsonierë, 1+1 dhe 2+1.
- Banesa sociale me qira pranë ish konviktit të shkollës Veterinare, ku janë në dispozicion 28 banesa 1+1 dhe 2+1. Jemi në proces të miratimit të listës së përfituesve dhe të qirasë sociale për këtë program.
- Banesat sociale për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin rom, ku janë në dispozicion 27 apartamente sociale me qira 1+1 dhe 2+1.

Gjithashtu Bashkia Shkodër në zbatim të nenit 23 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” ka marrë masa për publikimin e thirrjes për aplikime për subjekte të interesuar për të marrë statusin e “pronarit social”, por nuk ka patur asnjë aplikim nga subjekte të interesuar. Link: (https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/THIRRJE_P_R_APLIKIME_Pronar_social_1809_1.php).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Voltana ADEMI